



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2023:249564

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485377

**P.nr.513/2018**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.M nga ..., Lagja ..., Komuna e Drenasit, për vepër penale Lidhja e paautorizuar në shërbime, të parashikuar nga neni 321 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.nr.II.5013/2018, të datës 21.09.2018, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me datë 21.03.2024, në prani të Prokurorit të Shtetit Ali Ajdini, përfaqësueses së të dëmtuarës E.Gdhe të akuzuarit, me datë **21.03.2024**, mori dhe publikisht shpalli si dhe përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

**NDAJ TË AKUZUARIT: L.M**, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë ..., i lindur me datë... në ..., Komuna e Drenasit, ku edhe e ka vendbanimin Lagja ..., me numër personal të letërnjoftimit ..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobtë ekonomike, më parë i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij.

**Në bazë të nenit 362 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së.**

### REFUZOHET AKTAKUZA

**SE:** me datën 07.05.2018, është vërtetuar se në fermën e tij në ..., Komuna e Drenasit, i akuzuari pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, është kyçur në rrjet elektrik jashtë pikës matëse, ashtu që gjatë kontrollës nga ekipet e KEDS-it është vërejtur se ndërprerësi ishte në 0 Fd siguresa ishte e ndalur, ndërsa në fermë energjia elektrike shpenzohej nga degëzimi i bërë brenda fermës para pikës matëse, duke mundësuar kështu shpenzimin e energjisë elektrike pa matje, me ç'rast KEDS-it Distrikti në Prishtinë i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 495.98 €,-

**- me këtë kishte për të kryer vepër penale Lidhja e paautorizuar në shërbime, të parashikuar nga neni 321 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

**Pasi që Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë–Departamenti i Përgjithshëm Ali Ajdini në fillim të shqyrtimi gjyqësor është tërhequr nga aktakuza.**

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetët buxhetore.

E dëmtuara KEDS Distrikti në Prishtinë, për realizimin e kërkeses pasurore juridike lidhur me kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, udhëzohet në kontest civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm, me aktakuzën PP.nr.II.5013/2018, të datës 21.09.2018, ka akuzuar të akuzuarin për vepër penale Lidhja e paautorizuar në shërbime, të parashikuar nga neni 321 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Gjykata ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor me dt.21.03.2024, ku ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm Ali Ajdini, përfaqësuesja e të dëmtuarës E.G, i akuzuari dhe dëshmitari V.F.

Prokurori i shtetit në fillim të shqyrtimit gjyqësor, deklaroi se: heqi dorë nga ndëgjimi i dëshmitarit V.F dhe konstatoi se me ndëgjimin e ekspertit të elektrikës dhe me ekspertizën elektrike, u vërtetua fakti se në kohën e inkriminuar, sipas mendimit të ekspertit nuk ka mundur të vërtetohet se është manipuluar me rrymën elektrike dhe me orën e rrymës elektrike. Përveç kësaj procesverbalit të kontrollit të KEDS-it, fotografitë dhe profatura, nuk janë prova materiale në kuptim të dispozitave të KPP-së, sepse nuk janë marr nga organi që zbaton hetimin.

Prandaj mbi bazën e asaj që u tha më lartë, në mungesë të provave heqi dorë nga ndjekja penale.

Pasi që prokurori i shtetit në fillim të shqyrtimit gjyqësorë hoqi dorë nga ndjekja penale, ndaj të akuzuarit, për veprën penale që akuzohet, gjykata ka konstatuar se lidhur me këtë çështje më tutje nuk ka çka të procedoi.

Nga këto arsye në bazë të nenit 362 par.1. nënpar.1.1 të KPP-së, pasi që Prokurori i Shtetit i Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Pergjithshëm, në fillim të shqyrtimit gjyqësor është tërhequr nga aktakuza, gjykata ka marrë aktgjykim me të cilin ka refuzuar aktakuzën ndaj të akuzuarit L.M.

Vendimin që shpenzimet procedurale të paguhen nga mjetet buxhetore, gjykata e bazoi në nenin 453 par.1. të KPP-së.

Vendimin që të dëmtuaren KEDS Distrikti në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, të e udhëzoi në kontest civil, gjykata e merr në bazë të nenit 462 par.1. të KPK-së.

Nga e lartetheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

### **GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL P.nr.513/2018, datë:21.03.2024**

**Procesmbajtësja  
Elheme Kastrati**

**G j y q t a r i  
Shfqet Baleci**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, personat e autorizuar (të paraparë sipas nenit 381 par.1. të KPP-së), kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (e paraparë sipas nenit 374 par.1. nënpar.1.1. të KPP-së), në afat prej tredhjetë (30) ditëve (e paraparë sipas nenit 380 par.1. të KPP-së), duke llogaritur nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.

Ankesa e personit të autorizuar e paraqitur brenda afatit të caktuar si më lartë, e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit (e paraparë në bazë të nenit 380 par.3. të KPP-së).